

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 709 Prot.

Tiranë, më 27.10 2015

VENDIM Nr. 111, datë 21.10.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, të datës 21.10.2015, pasi shqyrtoi Relacionijn mbi *projektin e ndërtimit të HEC-VE në kaskadën e lumit Devoll, subjekti "Devoll Hydropower" sh.a.*, paraqitur nga ASHA,

VENDOSI:

- I. Ndryshimin pjesërisht të vendimit të KKA Nr. 189, datë 17.04.2012, në lidhje me pikën II të këtij vendimi, për kryerjen e sondazheve arkeologjike, në traktet e përcaktuara gjatë vëzhgimit arkeologjik, në *Site 2, Site 3, Site 4, Site 5, Site 6, Site 7 dhe Site 8*, në zonën ku do të zhvillohet *projekti i ndërtimit të HEC-VE në kaskadën e lumit Devoll, subjekti "Devoll Hydropower" sh.a.* Sondazhet do të kryhen nga shoqëri të licencuara në arkeologji.
- II. Subjekti "Devoll Hydropower" sh.a për kryerjen e këtyre sondazheve duhet të kontrakttojë shoqëri të licencuara në arkeologji, duke lidhur më parë kontratë tre palëshe me to dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikqyrë shoqëritë e licencuara. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
- III. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO